



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 652/2 Prishtinë 03.03. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Kreshnik Aliu** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Modelimi hidraulik I vërshimeve në lumin Morava**" në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është analiza e vërshimeve në lumin Morava, më konkretisht të bëhet një modelim i vërshimeve në vendin e menduar për ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura për Gjilanin dhe masat që duhet të ndërmerren më qëllim të mbrojtjes nga vërshimet ky lokacion.

Njeriu me mënyren e jetesës së tij është njëri ndër shkaktarët kryesor të vërshimeve duke e shfrytëzuar tokën përmes ndërtimeve, eksploatimit të pa kriter të shtretërve të lumenjve dhe hedhjes së mbeturinave në lumenj, ka ndikuar që të rritet shpeshtësia e vërshimeve, viteve të fundit. Ndryshimet klimatike gjithashtu janë ndër faktorët më me rëndësi që shkaktojnë vërshimet.

Në këtë punim, kam përdorur literaturën për vërshimet, llojet e vërshimeve, shkaktarët e vërshimeve, dëmet dhe dobitë prej vërshimeve. Kam përshkruar pellgun e lumit Morava, hidrologjinë e lumit së bashku me disa karakteristika të lumit Morava. Për të bërë modelimin kam bërë matje gjeodezike për sipërfaqen vërshuese në segmentin ku është bërë studimi. Pastaj duke llogaritur të plotat me të dhënat maksimale të matjeve në stacionin e Korminjanit me metodat statistikore të Gumbel-it, Pearson-it, log Pearson-it, metodën normale dhe log normale, janë llogaritur prurjet e plota për këtë stacion, pastaj me interpolim hapsionor të pellgut Morava janë llogaritur prurjet në vendin e studimit. Ku sispas rezultateve të llogaritura dhe rëndësisë së objektit për të cilin është bërë studimi, prurja që është marrë për bazë është prurja maksimale 100 vjeçare me vlerën maksimale të llogaritur $Q_{maks} = 310.13 \text{ m}^3/\text{s}$.

Prurjen maksimale 100 vjeçare është futur në HEC RAS ku kam bërë modelimin hidraulik të vërshimeve për segmentin e trajtuar dhe sipas rezultateve, është përaktuar që lokacioni i studiuar është mjaftë i rrezikuar nga vërshimet.

Në përfundim të këtij punimi, konkludojmë se mbrojtja nga vërshimet për segmentin e trajtuar të lumit Morava, nuk është e mjaftueshme për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë së objektit që do të ndërtohet në zonën e studiuar. Gjithashtu vlen të theksohet edhe kapaciteti aktual i shtratit të lumit me argjinaturat e tij është zvogëluar për shkak të mosmirëmbajtjes së tij.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.